

Vizioni strategjik për Qeverisje të Hapur - OGP Lokal

Kohëzgjatja

Data e mbarimit të mandatit aktual qeverisës (muaji/viti)

11/2025

Data e skadimit të planit të veprimit (muaji/viti)

(Dy muaj para përfundimit të mandatit qeverisës)

9/2025



Të dashur qytetarë,

Është një nder dhe privilegj për mua që të paraqes këtë plan për qeverisje të hapur, një iniciativë e cila synon të përmirësojë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen publike. Ky plan është rezultat i një pune të gjatë dhe të përkushtuar, ku janë përfshirë organizata të shoqërisë civile dhe mbi të gjitha, vetë ju – qytetarët e komunës sonë.

Në kohën kur qeverisja e hapur është bërë një standard global, ne kemi vendosur që të jemi pjesë aktive e këtij procesi transformues. Ky plan do të na mundësojë të ndërtojmë një qeverisje më të përgjegjshme dhe më efikase, duke siguruar që çdo vendim të jetë i bazuar në të dhëna të sakta dhe të qarta, si dhe të jetë i hapur për shqyrtim publik.

Me këtë plan, ne synojmë jo vetëm të përmirësojmë mënyrën se si funksionon administrata komunale, por edhe të krijojmë një kulturë të re të qeverisjes, ku transparenca dhe pjesëmarrja janë shtyllat kryesore.

Jam i bindur se me bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj, do të arrijmë të ndërtojmë një të ardhme më të mirë dhe më të drejtë për të gjithë.

Ju ftoj që të lexoni këtë plan me vëmendje dhe të bëheni pjesë e këtij procesi transformues. Së bashku, mund të ndërtojmë një komunë më të hapur dhe më të suksesshme.

Sinqerisht,

Kadri Rahimaj

Kryetar i Komunës së Kamenicës



Si kryetare e Forumit për Transparencë Komunale, unë do të udhëheq me përkushtim dhe përgjegjësi për të siguruar që qeverisja e hapur të jetë prioriteti kryesor për komunën tonë. Plani im i veprimit do të përfshijë:

1. Komunikim i hapur dhe transparent me qytetarët dhe aktorët e tjerë të interesuar për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien në vendimmarrjen komunale.
2. Zbatim i politikave dhe procedurave të qeverisjes së hapur për të siguruar llogaridhënien, përgjegjësinë dhe efikasitetin në administratën komunale.
3. Ndërtimi i partneritetit me organizatat e shoqërisë civile dhe mediat lokale për të promovuar transparencën dhe llogaridhënien në vendimmarrjen komunale.
4. Monitorimi dhe vlerësimi i performancës së administratës komunale për të siguruar përmirësimin e qeverisjes së hapur.
5. Zhvillimi i programeve të edukimit dhe sensibilizimit për qytetarët për të rritur ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse komunale. Me këtë plan të veprimit, unë besoj se do të sigurojmë një qeverisje të hapur, transparente dhe përgjegjëse për të gjithë qytetarët e komunës tonë.

Sinqerisht,

Donjeta Ismajli

Kryetare e Forumit për Transparencë Komunale

Sfidat, mundësit, dhe vizioni strategjik për Qeverisje të Hapur

Ky nënkapitull detajon Vizionin Strategjik për Qeverisje të Hapur në nivelin lokal që duhet të udhëzoj zotimet e planit të veprimit:

Cili është vizioni afatëgjatë për qeverisje të hapur në kontekstin e qeverisjes tuaj lokale?

Komuna e Kamenicës në vazhdimësi ka ndërmarrë veprime dhe masa adekuate me qëllim përmirësimin e parimeve të qeverisjes së mirë lokale, por gjithashtu edhe për të qenë në linjë me standardet ndërkombëtare dhe vlerat e promovuara nga OGP.

Në vijim janë disa nga vlerat të cilat do të jenë në fokus të Komunës në vitet në vijim:

1. **Transparenca:**

- Publikimi i të dhënave dhe informacionit në mënyrë të hapur dhe të arritshme për të gjithë qytetarët.
- Raportimi i rregullt dhe i detajuar mbi vendimet dhe shpenzimet e komunës.

2. **Pjesëmarrja e Qytetarëve:**

- Përfshirja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes përmes konsultimeve publike, dëgjësave dhe forumeve të hapura.
- Krijimi i mekanizmave që lejojnë qytetarët të kontribuojnë me mendime dhe ide.

3. **Llogaridhënia:**

- Mbajtja e përgjegjësisë për vendimet dhe veprimet e ndërmarra nga zyrtarët dhe institucionet komunale.
- Zbatimi i politikave dhe procedurave për të siguruar që zyrtarët të jenë të përgjegjshëm ndaj qytetarëve.

4. **Inovacioni dhe Teknologjia:**

- Përdorimi i teknologjisë për të përmirësuar shërbimet publike dhe për të lehtësuar komunikimin me qytetarët.
- Inkurajimi i inovacionit për të adresuar sfidat lokale dhe për të përmirësuar efikasitetin.

5. **E Drejta për Informim:**

- Sigurimi që qytetarët të kenë akses të lirë dhe të plotë në informacionin publik.

- Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve që mbrojnë të drejtën e informimit.

6. Barazia dhe Përfshirja Sociale:

- Promovimi i barazisë në aksesin ndaj shërbimeve publike dhe përfshirja e të gjitha grupeve shoqërore në proceset e vendimmarrjes.
- Eliminimi i diskriminimit dhe promovimi i politikave që mbështesin grupet e marginalizuara.

7. Efikasiteti dhe Efektiviteti:

- Menaxhimi i burimeve publike në mënyrë efikase dhe efektive për të ofruar shërbime cilësore.
- Vlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i performancës së komunës.

Meqë qeverisja e mirë arrihet me rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe gjithpërfshirës, Komuna e Kamenicës ka shprehur gatishmërinë dhe vullnetin për të arritur objektiva ambicioze specifike në nivelin lokal, si në vijim:

1. **Përmirësimi i ambientit dhe klimës** në nivelin lokal duke hartuar planin për menaxhim të integruar të mbeturinave, promovim të transportit alternativ, dhe krjimin e kushteve të përshtatshme për prodhim të energjisë së pastër.
2. **Avancimi i qeverisjes lokale përmes digjitalizimit**, duke funksionalizuar [platformën digjitale shkollore](#) dhe zhvillimi i platformës për komunikim dhe ndërveprim me qytetarë në bashkëpunim me Universitetin Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan.
3. **Rritja e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së qytetarëve** në procese politikëbërse dhe vendimmarrëse në qeverisjen lokale duke avancuar përfshirjen e të gjitha grupeve të shoqërisë, me theks të veçantë në prioritetet e grave, personave me aftësi të kufizuara, komuniteteve jo-shumicë, dhe rinisë.
4. **Zbatimi i praktikave për buxhetim me pjesëmarrje**, duke iu mundësuar qytetarëve pjesëmarrje proaktive në procesin e planifikimit buxhetor në Komunë, me theks të veçantë në integrimin e perspektivave të grave, personave me aftësi të kufizuara, komuniteteve jo-shumicë, dhe rinisë.

Cilat janë disa nga arritjet tuaja në qeverisje të hapur (për shembull, reformat më të fundit për qeverisje të hapur)?

(Maksimum 1500 shkronja/hapësira)

Komuna e Kamenicës ka ndërmarrë masa/hapa konkret për përmirësimin e qeverisjes në nivelin lokal. Në bashkëpunim me shoqërinë civile, Komuna ka identifikuar fushat me prioritet për komunitetin dhe është angazhuar në adresimin e tyre:

- **Informimi i qytetarëve mbi punën e Komunës**

Në mënyrë që qytetarët të jenë më të informuar mbi punën e Komunës, në kanalet zyrtare (uebfaqe, profili në Facebook etj.) janë **publikuar informatat dhe dokumentet publike** (kontratat, raportet financiare, raportet e punes, agjenda e kryetarit të Komunës etj.) brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj, si dhe është

zhvilluar **buletini i Komunës** për të paraqitur punën e zyrtarëve komunal. Ky buletin pastaj shpërndahet në format të shtypur dhe digjital tek të gjithë qytetarët në territorin e Komunës së Kamenicës.

- **Krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë**

Komuna është angazhuar në ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët, pa dallim gjinie, të entitetit, të gjendjes shoqërore dhe financiare, apo të ndonjë dallimi tjetër, si:

- Hartimi i Planit të Veprimit për Barazi Gjinore;
- Themelimi i **Komitetin veprues për të drejtat e komunitetit Romë dhe Ashkali** për të mbrojtur dhe ofruar mundësi më të mira integrimi në komunitet dhe vendimmarrje;

- **Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje**

Përkundër që pjesëmarrja e qytetarëve është sfidë, Komuna është angazhuar në krijimin e mundësive adekuate që qytetarët të marrin pjesë në konsultime publike:

- Kthimi i përgjigjeve në kërkesat/pyetjet e qytetarëve brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj;
- Organizimi i konsultimeve publike në pjesën dërrmuese të territorit të Komunës, duke i angazhuar Këshillat Lokal në organizimin e konsultimeve publike me qytetarë;
- Prezantimi i planit buxhetor dhe projekteve komunale nga Kryetari i Komunës përmes platformave digjitale dhe me prezencë fizike;

- **Zhvillimi i platformës për menaxhim të sistemit arsimor në nivel komunal**

Avancimi i komunikimit me prindërit përmes platformave digjitale, si:

- Mundësimi i organizimit të orës mësimore përmes platformës;
- Informata në kohë reale mbi zhvillimet në shkollë për prindët, mësimdhënësit dhe DKA.
- Raporte profesionale dhe kredibile për rezultatet shkollore.

- **Buxhetimi me pjesëmarrje**

Buxhetimi me pjesëmarrje (BP) është një proces demokratik që lejon qytetarët të kenë një zë të drejtpërdrejtë në vendosjen e prioriteteve për shpenzimet publike. Ky proces i përfshin anëtarët e komunitetit në diskutimet dhe vendimet mbi mënyrën se si duhet të shpenzohen fondet publike, duke u dhënë atyre mundësinë të propozojnë dhe të votojnë për projekte specifike që konsiderojnë të rëndësishme për nevojat dhe zhvillimin e komunitetit të tyre. Me qëllim të realizimit të buxhetimit me pjesëmarrje, komuna përfshinë palët e interesuara në këtë proces, të cilat janë listuar si vijon:

- **Organet Komunale:** Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave planifikojnë procesin e posaçërisht, menaxhojnë procesin e konsultimit deri tek

finalizimi duke përfshirë organizimin e takimeve publike, kampanjës informuese, identifikimin e lokacioneve, organizimin e procesit të votimit si dhe adresimin e çështjeve prioritare të përzgjedhura nga qytetarët, të cilat adresohen në draftin e buxhetit për vitin e ri fiskal dhe të njejtin t'a adresojnë tëk kuvendi i komunës. Në këtë kuadër, edhe anëtarët e Kuvendeve të Komunave kanë rolin e tyre për të inkurajuar pjesëmarrje sa më të madhe të qytetarëve në këtë proces, sipas zonave apo lokacioneve që ata i përfaqësojnë duke u kujdesur që këto propozime të përfshihen në draft-buxhet. Buxheti miratohet nga Kuvendi i Komunës me datë 30 Shtator.

- **Qytetarët:** Qytetarët duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive duke u mobilizuar në komunitetet e tyre për të adresuar sa më mirë kërkesat dhe prioritetet e komunitetit.
- **Aktivistët lokal:** Përvec grupeve të formalizuara, janë edhe aktivistët lokal të cilët si individë por që i përkasin grupeve jo-formale (arkitektët, ciklistët, klubet e ngjitjeve, bletarët, fermerët në mënyrë vullnetare angazhohen për interesin e përbashkët dhe kontributin e tyre në komunitet.
- **Përfaqësuesit e shoqërisë civile:** Si grupe të formalizuara organizatat e shoqërisë civile kanë ndikimin e tyre për të mobilizuar qytetarët që të marrin pjesë në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje.
- **Këshillat Lokal:** Në kuadër të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje, roli i këshillave lokal është që të inkurajojnë qytetarët të marrin pjesë aktivisht në këtë proces e njëkohësisht të mbledhin dhe prioritojnë kërkesat e tyre.

Cilat janë sfidat/fushat aktuale për qeverisje të hapur që qeverisja juaj lokale dëshiron t'i adresoj?

Përkundër angazhimit të vazhdueshëm për përmirësim në fushën e transparencës, llogaridhënies dhe gjithpërfshirjes, Komuna në bashkëpunim me shoqërinë civile ka identifikuar fushat/sfidat që duhet të adresohen nga Komuna:

1. Komuna ka themeluar Qendrën Teknologjike dhe Inkubatorin e Biznesit me qëllim rimëkëmbjen ekonomike të Komunës dhe krijimin e mundësive të reja për punë, por ka mungesë të kuadrove të reja të nevojshme për funksionalizimin e tyre. **Qendra Teknologjike tashmë ka edhe menaxherin e saj, Cactus Education, të cilët janë shpallur përfitues i ankandit publik për menaxhimin e Qendrës Teknologjike. Dhe kanë nisur procedurat rekrutuese për koordinatorin dhe asistentët administrativ që do të angazhohen në kuadër të kësaj qendre.** Më tutje, Komuna planifikon që të hartojë një plan të subvencionimit të bizneseve të vogla dhe të mesme që do të bëhen pjesë e inkubatorit, si dhe do të krijoj mundësi për ngritje të kapaciteteve për rininë në fushën e shkencave kompjuterike, financa, menaxhment dhe hartim të projekteve të nevojshme për funksionalizimin e Qendrës Teknologjike.
2. Komuna ka një përparësi gjeografike në krahasim me Komunitat tjera, por potenciali i plotë i saj nuk është duke u shfrytëzuar. Andaj, njëra nga synimet e Komunës është përcaktimi i hapësirave dhe krijimi i kushteve për investime (të brendshme dhe të huaja) në fushën e prodhimit të energjisë së pastër, që do të kontribuonte në zhvillimin ekonomik në nivelin lokal dhe qendror.

3. Një sfidë tjetër e Komunës është problemi me mbeturina, duke shkaktuar ndotje të ambientit. Në këtë drejtim, Komuna synon hartimin e rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave.
4. Edhe pse Komuna ka ndërmarrë veprime inovative në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politikëbërëse dhe vendimmarrëse, vetëdijësimi i qytetarëve për rëndësinë e pjesëmarrjes në këto procese mbetet ende i ulët. Kjo ndikon drejtpërdrejt në uljen e pjesëmarrjes dhe angazhimit qytetar në politikëbërje lokale. Andaj, Komuna e sheh të rëndësishme ngritjen e vetëdijes së qytetarëve dhe promovimin e vlerave dhe praktikave të qeverisjes së hapur në gjithë territorin e Komunës.
5. Sfidë për Komunën e Kamenicës është numri i ulët i grave dhe personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës, duke zbehur kështu nivelin e gjithpërfshirjes në nivel komunal. Andaj, Komuna ka ndërmarrë veprime që fuqizon gratë dhe personat me aftësi të kufizuara të Komunës së Kamenicës, si në vijim:
 - a. Lirimi nga taksat për bizneset me pronare gra dhe persona me aftësi të kufizuara përmes rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale;
 - b. Subvencionimi i grave lehona dhe familjet e tyre me pako financiare dhe materiale;
 - c. Hartimi i Planit të Veprimit për Barazi Gjinore;
 - d. Sigurimi i perspektives gjinore gjatë planifikimit të buxhetit komunal.

Cilat janë synimet afatëmesme për qeverisje të hapur që dëshironi t'i arrini?

Komuna e Kamenicës do të angazhohet që gjatë periudhës së planit të veprimit të realizoj këto objektiva:

1. Përmirësimi i ambientit dhe klimës në nivelin lokal

Hartimi i planit komunal për menaxhim të mbeturinave; Hartimi i projektit detal dhe inicimi i procedurave të prokurimit për realizimin e transportit alternativ në Komunë; hartimi i Planit Zhvillimor Komunal që përcakton destinimin e pronave publike dhe

private për zhvillim dhe ndërtim urban; si dhe identifikimi i lokacioneve për zhvillim të parqeve solare dhe erës.

2. Digjitalizimi i sistemit arsimor në nivel komunal

Funksionalizimi i [platformës digjitale shkollore](#) dhe zhvillimi platformës për komunikim dhe ndërveprim me qytetarë.

3. Rritja e pjesëmarrjes dhe përfshirjes së qytetarëve në procese politikëbërse dhe vendimmarrëse në qeverisjen lokale

Avancimi i praktikave për buxhetim me pjesëmarrje për t'iu mundësuar qytetarëve pjesëmarrje proaktive në procesin e planifikimit buxhetor në Komunë, si dhe **përfshirja e perspektivës gjinore** gjatë procesit.

Si kontribuon ky plan i veprimit në arritjen e Vizionit Strategjik për Qeverisje të Hapur?

Bazuar në punën dhe qëllimin e administratës aktuale komunale për qeverisje të hapur, plani i veprimit do të kontribuoj në ndërtimin e një vizioni strategjik duke përfshirë zotime në tri fusha strategjike.

Zotimi i parë do të adresoj një problem global, konkretisht synon të ndërmarrë masa konkrete për mbrojtjen e mjedisit, gjë që kontribuon në klimën globale. Komuna synon krijimin e mundësive dhe kushteve për investime të brendshme apo të huaja në prodhimin e energjisë së pastër; të promovoj transportin alternativ (me biçikleta); si dhe të rregulloj menaxhimin e mbeturinave. Duke adresuar këto çështje, Komuna e Kamenicës synon që të përmirësoj ambientin dhe jetën e qytetarëve.

Zotimi i dytë synon që të përmirësoj hapjen dhe transparencën komunale përmes qeverisjes digjitale, duke mundësuar që qytetarët të ndërveprojnë dhe komunikojnë më shpejtë dhe lehtë me zyrtarët komunal, drejtorinë për arsim dhe me shkollat në Komunën e Kamenicës.

Zotimi i tretë dhe i katërt synojnë inkurajimin dhe rritjen e pjesëmarrjes të të gjitha grupeve të shoqërisë në Kamenicë në procese politikëbërse dhe vendimmarrëse të qeverisjes lokale, me fokus të veçant gratë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet jo-shumicë, dhe rininë.

Si kontribuon ky vizion strategjik për qeverisje të hapur në arritjen e synimeve të përgjithshme të qeverisjes lokale?

Vizioni strategjik për qeverisje të hapur kontribuon në arritjen e synimeve të Komunës së Kamenicës për të përmirësuar transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në linjë me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, duke u bërë kështu pjesë e komunitetit ndërkombëtar që promovon vlera të larta demokratike.

Angazhimi dhe koordinimi në Vizionin Strategjik dhe Planin e Veprimit për Qeverisje të Hapur

Ju lutem listoni institucionet/departamentet/njësitë qeveritare përgjegjëse për zbatim të planit të veprimit.

Institucionet/departamentet/njësitë qeveritare
Zyra e Kryetarit të Komunës
Drejtoria Komunale e Arsimit
Zyra për informim
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Drejtoria për Urbanizëm, Mjedis dhe Planifikim Hapesinor
Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë
Drejtoria e Investimeve Kapitale
Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut
Zyra për Barazi Gjinore
Drejtoria për Financa dhe Buxhet
<i>Shtoni rreshta aq sa iu duhen</i>

Çfarë masa/veprime janë ndërmarrë në nivelin institucional për të siguruar koordinim ndërmjet institucioneve/departamenteve/njësive qeverisëse për të zbatuar planin e veprimit?

Komuna e Kamenicës është e zotuar që të sigurojë zbatimin e planit të veprimit për qeverisje të hapur. Fillimisht, Komuna do të krijojë një kanal komunikimi ndërmjet njësive/departamenteve të qeverisjes lokale për të siguruar që zbatimi i planit të veprimit të bëhet në koordinim të plotë dhe për tejkalim më të lehtë dhe shpejtë të çfarëdo pengesave që mund të dalin rrugës.

Çfarë hapësira janë përdorë apo krijuar për të mundësuar bashkëpunim ndërmjet qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile për të bashkëkrijuar dhe zbatuar këtë plan të veprimit?

Komuna e Kamenicës më datë 28 prill 2023 ka themeluar Forumin për Transparencë Komunale, një mekanizëm gjithpërfshirëse, si një trupë këshilldhënës për bashkë-krijimin, koordinimin dhe zbatimin e planit të veprimit për qeverisje të hapur:

- **Forumi për Transparencë Komunale** - përbëhet nga përfaqësues të Komunës së Kamenicës, si nga ekzekutivi, legjislativi dhe përfaqësues të organizatave lokale të shoqërisë civile që kanë fushëveprimtari të ndryshme. Disa nga funksionet janë:
 - Zhvillimi i Planit të Veprimit, ku përcaktohen zotimet kyçe të Komunës për një periudhë kohore;
 - Zhvillimi i takimeve të rregullta të anëtarëve për të diskutuar çështje që ndërlidhen me zotimet e Planit të Veprimit;
 - Mundësimi i hapësirës për bashkëpunim ndërmjet Komunës dhe shoqërisë civile, por edhe me grupe dhe komunitete të tjera që jetojnë dhe veprojnë në Komunën e Gjakovës;
 - Monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit.

Çfarë masa/veprime keni ndërmarrë për të siguruar përfaqësim gjithpërfshirës (përfshirë grupet e ndjeshme apo të marginalizuara) në këto hapësira?

Forumi për Transparencë Komunale është themeluar nga Komuna me qëllim të gjithpërfshirjes në procese politikëbërëse dhe vendimmarrëse të qeverisjes lokale.

Organizatave lokale të shoqërisë civile që janë pjesë e Forumit për Transparencë Komunale janë të fokusuar në mbrojtjen e të drejtave të rinisë, të grave, të personave me aftësi të kufizuara, si dhe të komuniteteve jo-shumicë që jetojnë dhe veprojnë në Komunën e Kamenicës.

Kush ka marrë pjesë në këto hapësira?

Përmend llojet e grupeve të ndryshme që kanë marrë pjesë në procesin bashkëkrijues.

Në procesin e bashkë-krijimit kanë marrë pjesë:

- Përfaqësues të shoqërisë civile
- Zyrtarë/shërbyes civil të komunës

- Anëtarë të Kuvendit Komunal

Numri i grupeve që kanë marrë pjesë në këto hapësira:

3

Numri i takimeve të organizuara gjatë procesit të bashkëkrijimit:

5

Si do të vazhdoj bashkëpunimi ndërmjet qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile për të zbatuar planin e veprimit?

Forumi për Transparencë Komunale do të mbliidhet në baza të rregullta mujore për të diskutuar progresin e zbatimit të zotimeve. Në rast të nevojës, Forumi do të ftojë për pjesëmarrje në takime akterë të tjerë që mund të kontribuojnë apo mbështesin aktivitete kyçe që kontribuojnë në realizimin e zotimeve të planit të veprimit.

Në bazë të nevojës, Forumi mund të krijoj grupe punuese me tematikë specifike që ndërlidhet me zotimet, dhe këto grupe do të ngarkohen me detyrën për të analizuar gjendjen aktuale dhe propozimin e hapave konkret që duhet të ndërmerren për të siguruar zbatimin e zotimeve të planit të veprimit.

Mbikëqyrja e Planit të Veprimit

Ju lutem përshkruani mekanizmin që do të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të planit të veprimit.

Në raport me mbikëqyrjen e Planit dhe implementimin e tij do të mirret drejtpërdrejtë grupi i cili do të caktohet nga Forumi për Transparencë Komunale.

Ju lutem vendosni detajet e kontaktit për anëtarët e mekanizmit mbikëqyrës.

Personi kontaktues	Pozita	Email

Shtoni rreshta aq sa iu duhen

Çfarë lloj aktivitete/veprime planifikohen të bëhen për të diskutuar mbi progresin e zbatimit të zotimeve?

Do të mbahen takime të rregullta për të diskutuar progresin eventual në raport me zotimet në këtë plan. Pra, grupi i cili do të percaktohet nga Forumi, do të hartoj raport mbi progresin eventual të zbatimit të planit të veprimit dhe do ta prezantoj atë në mbledhje të Forunit.

Si do të bëhet kontrolla e rregullt për progresin e zbatimit me bartësit e zotimeve përkatëse?

Grupi punues, i themeluar nga Forumi, do të qendrojë në komunikim të rregullt me bartësit e zotimeve dhe të gjeturat do të paraqiten në një raport me shkrim i cili prezantohet në mbledhje të Forunit.

Si do të informohet publiku për rezultatet e mbikëqyrjes?


Publiku do të informohet nëpërmjet kanaleve zyrtare të Komunës së Kamenicës, e cila do të bëhet nëpërmjet publikimit të raporteve, infografikave, fletushkave digjitale e postimeve. Gjithashtu, një menyrë tjetër e informimit do jetë edhe mbajtja e degjimeve publike me grupe të caktuara specifike të cilat targetohen nga zotime specifike të planit.

Mbështetja nga organizata joqeveritare

Listoni organizatat joqeveritare që kanë marrë pjesë në procesin bashkëkrijues dhe që mbështesin këtë plan të veprimit.

Personi kontaktues	Pozita	Emri i organizatës	Email
Sherafedin Vranja	Drejtor	Dardana Press	baqa65@hotmail.com
<i>Shtoni rreshta aq sa iu duhen</i>			

DRAFT



Plani i veprimit - OGP Lokal


Aktivitetet/masat për arritjen e zotimeve të planit të veprimit

Ky kapitull përmban përshkrime të detajuara mbi zotimet për qeverisje të hapur. Këto zotime janë nisma afatë-mesme konkrete për të arritur rezultate afatë-mesme të identifikuara në Vizionin Strategjik për Qeverisje Lokale të Hapur.

Më poshtë është shablloni me fusha që duhet të plotësohen me informata të rëndësishme për finalizimin e planit të veprimit. Ju lutem keni kujdes në kufizimin e fjalëve për secilën fushë.

Shënim me rëndësi: *Duhet të keni parasysh që plani i veprimit përfundimtar do të dorëzohet përmes platformës digjitale të ofruar nga OGP Lokale.¹*

¹ Dorëzimi i planit të veprimit te OGP Lokal bëhet vetëm pas anëtarësimit të Komunës në këtë rrjet ndërkombëtar.



Objektiva/zotimi 1:

(Maksimum 250 shkronja/hapësira)


Përmirësimi i ambientit dhe klimës në nivelin lokal

Afatet kohore

Data e fillimit për zbatim të zotimit (muaji/viti): 11/2024


Data e përfundimit për zbatim të zotimit (muaji/viti): 09/2025

DRAFT



Bartësit e zbatimit në nivelin e qeverisjes lokale

Zyra, Departamenti, Agjencia apo institucioni përkatës	Dega e qeverisjes lokale (Zgjedh nga lista)	Personi kontaktues	Titulli	Email	Roli në zbatim (Zgjedh nga lista)
Zyra per informim	Ekzekutiv	Lidiona Marovca	Zëdhëse	lidiona.marovca@rks-gov.net	Mbështetës
Zyra e Kryetarit	Ekzekutiv	Vaxhid Rexhepaj	Shef i Kabinetit	vaxhid.rexhepaj@rks-gov.net	Koordinator
Drejtoria per Urbanizem, Planifikim Hapesinor	Ekzekutiv	Uran Berisha	Drejtor	uran.berisha@rks-gov.net	Bartës
Drejtoria per Sherbime Publike, Inspektorat, Ambient dhe Emergjenca	Ekzekutiv	Zotrim Kastrati	Drejtor	zotrim.kastrati@rks-gov.net	Bartës
Kuvendi Komunal	Legjislativ	Liridon Kastrati	Kryesues	liridon.kastrati@rks-gov.net	Mbështetës
Forumi për Transparencë Komunale		Donjeta Ismajli	Kryetare	donjeta.ismajli@rks-gov.net	Mbikëqyrës
<i>Shtoni rreshta aq sa ju duhen</i>					



Bartësit për zbatim nga sektori i organizatave joqeveritare

<i>Emri i organizatës</i>	<i>Personi kontaktues</i>	<i>Titulli</i>	<i>Email</i>	<i>Roli në zbatim</i> (Zgjedh nga lista:)
Dardana Press	Sherafedin Vranja	Drejtor	baqa65@hotmail.com	Mbështetës
<i>Shtoni rreshta aq sa ju duhen</i>				


Bartës të tjerë për zbatim të këtij zotimi

<i>Emri i organizatës</i>	<i>Personi kontaktues</i>	<i>Titulli</i>	<i>Email</i>	<i>Roli në zbatim</i> (Zgjedh nga lista:)
				Roli?
<i>Shtoni rreshta aq sa ju duhen</i>				

Përshkrimi i zotimit

1. Problemi

Përshkruani problemin që keni identifikuar dhe të cilin synon ta zgjidh ky zotim :



Mungesa e vetëdijësimit, kujdesjes për mjedisin, dhe investimet pa masa eficiente kanë bërë që ky të jetë një nga problemet në Komunën e Kamenicës, për të cilin zotohemi se do të krijojmë kushte për zgjidhje dhe përmirësim. Gjithashtu, një problem tjetër i vënë re nga Komuna e Kamenicës është edhe krijimi i deponive ilegale në hapësira publike, ku një hap në këtë drejtim është hartimi i Planit për Menaxhimin e Mbeturinave.

2. Gjendja ekzistuese

Përshkruani gjendjen aktuale në të cilën gjendet çështja në fjalë në periudhën e hartimit të planit të veprimit (p.sh. 26% e kërkesave të qytetarëve nuk janë shqyrtuar ende) (Maksimumi 1000 shkronja/hapësira)

Komuna e Kamenicës, falë punës së madhe në vitet e fundit, është shpallur edhe Kampione e Gjellbër e Ballkanit Perëndimor. Por në këtë sektor ka ende punë për t'u bërë. Kamenica ende nuk ka një deponi për mbeturinat, por një start i mirë në këtë fushë është Plani për Menaxhimin e Mbeturinave. Në të njëjtën kohë është bërë vendosja e kamerave në hapësira të ndryshme publike për deponitë ilegale të krijuara tash e sa vite në Komunën e Kamenicës. Janë bërë hapa drejt këtij zotimi por ka ende punë për tu bërë.


3. Veprimet

Cili është zotimi? Përshkruaj se çfarë përfshinë ky zotim, rezultatet e pritura, dhe objektiva e përgjithshme. (Maksimumi 1000 shkronja/hapësira)

Zotimi në fjalë është krijimi i mundësive për investime të brendshme apo të huaja në prodhimin e energjisë së pastër, të promovojë transportin alternativ dhe të rregullojë menaxhimin e mbeturinave. Rezultatet e përgjithshme janë investime në fushën e energjisë së pastër si dhe promovimi dhe eventualisht përdorimi i transportit alternativ. Në të njëjtën kohë edhe zgjidhja e problemit në raport me menaxhimin e mbeturinave.

4. Si do të kontribuoj ky zotim në zgjidhjen e problemit publik?

Cilat janë arritjet dhe rezultatet e pritura pasi të zbatohet zotimi?



Me zbatimin e këtij zotimi do të bëhet largimi i deponive ilegale, do të krijohet hapësira për përdorimin e transportit alternativ si dhe do të krijohen kushtet dhe hapësirat e nevojshme për investimet e huaja në fushën e energjisë së pastër.


5.Me cilën nga synimet afatëgjata të identifikuara në Vizionin Strategjik për Qeverisje të Hapur ndërlihet ky zotim?

Komuna e Kamenicës zotohet se do të bëjë të mundur menaxhimin e mbeturinave, rritjen e investimeve që qojnë në prodhimin e energjisë së pastër, si dhe gjithashtu do të promovojë edhe transportin alternativ. Ky zotim lidhet drejtpërdrejtë me vizionin e përmirësimit të ambientit dhe klimës në nivel lokal.

6.Fusha parësore

Ju lutem përcaktoni politikën apo praktikën më relevante për këtë zotim. Mund të zgjedhni deri në dy fusha të politikave nga lista në vijim: Deklarimi i pasurisë; Auditimet & kontrollat; Pronësia përfituese; Hapësirë për qytetari; Konflikt i interesit; Masa ndaj krizave; Qeverisje digjitale; E-peticionet; Zgjedhje dhe financat e partive politike; Hapja fiskale; Gjithpërfshirje; Hapje e legjislativit; Lobim; Kontraktim i hapur; Të dhëna të hapura; Prokurim publik; Rregullative; Qeverisje; E drejta për informim; Mekanizma sigurie & gjithpërfshirje ekonomike; Llogaridhënie sociale; Shtysë & rimëkëmbje ekonomike; Taksa; Mbrojtje e sinjalizuesve; Tjera/Nuk aplikohet.

1. Qeverisje
2. Shtyse dhe rimekembje ekonomike
3. Te tjera



7. Sektori parësorë

Ju lutem përcaktoni sektorin parësorë më relevant për këtë zotim. Mund të zgjedhni deri në dy sektorë nga lista në vijim: Ndhmë; Shtetësia & migracion; Ndër-sektorial; Arsim; Ambient & klimë; Industrinë nxjerrëse; Shëndeti & ushqyeshmëria; Infrastruktura & transporti; Drejtësi; Planifikimi për hapësira dhe prona publike; Ligjërje; Media dhe telekomunikimi; Polici & korrigjime; Sektor privat; Shërbime publike (të përgjithshme); Shkencë & teknologji; Siguria e publikut; Ujë, kanalizim, dhe higjiena; Tjera/Nuk aplikohet.


1. Ambient dhe klime
2. Planifikimi për hapësira dhe prona publike

8. Me cilën nga vlerat e OGP ndërlidhet ky zotim?

Zgjedhni vlerën nga lista në vijim:	Çfarë ndërlidhje ka ky zotim me këtë vlerë?
Llogaridhënie publike	Zotimi në fjalë përkon me vlerën e OGP-së për llogaridhënie publike meqë përmes aktiviteteve dhe veprimeve që do të ndërmerren do të kontribuojnë drejtpërdrejt në rrijten e llogaridhënies së Komunës ndaj qytetarëve të saj.
<i>Shtoni rreshta aq sa iu duhen</i>	

9. Çfarë burime nevojiten për arritjen e këtij zotimi?

Ju lutem përshkruani të gjitha burimet e nevojshme për arritjen e zotimit, përfshirë buxhetin, personelin, kohën dhe kontributet nga shoqëria civile dhe organizata të tjera.



Buxheti <i>(shënoni shumën buxhetore që duhet për t'u realizuar zotimi)</i>	Personeli <i>(numri i personelit të nevojshëm për zbatim të zotimit)</i>	Koha <i>(sa muaj nevojiten për zbatim të zotimit?)</i>	Burime të tjera <i>(Ju lutem përshkruani burimet të tjera që nevojiten për zbatim të zotimit)</i>
-	7	-	
